

DEKLARATË E KËSHILLIT KOMËTAR TË URDHRIIT TË MJEKËVE TË SHQIPËRISË

Reagim ndaj ndërhyrjes arbitrare në punët e Urdhrit te mjekëve.

K. Kombëtar i U.M.SH.-së u mbledh sot në një seancë të jashtëzakonshme, për t'u njohur me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shpallur me 15/10/2015, me të cilën u shpallën të pavlefshme zgjedhjet e K. Kombëtar dhe presidenti i ri, të organizuara nga Asambleja e Përgjithshme e U.M.SH.-së me 17/04/2015, kjo pas shqyrtimit të padisë së ngritur nga Dr. Valbona Doçi, drejtoresh e Qendrës së Transfuzionit të Gjakut në Tiranë.

Ky vendim për ne është absolutisht i padrejtë, absurd dhe i çuditshëm, prandaj ne shprehim habinë dhe indinjatën tonë.

U.M.SH.-ja është ent publik jo buxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon Veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

Përse ndërhyet në punët e U.M.SH.-së?

Kuji i intereson cënimi i pavarësisë sonë?

Përse vlejne këto procese gjyqësore me padi të sajura dhe të mbështëtura nga Ministria e Shëndetësisë, si palë e tretë aktive në procesin gjyqësor?

Znj.Doçi edhe pse me disa pengesa ligjore për të vënë kandidaturë (statusi politik, pozicion administrativ) dhe pa asnjë kontribut në U.M.SH.-në u lejua të votohej dhe mori përgjigje nga rezultati i votimit në K. Kombëtar 17 vota për Dr. Brahimaj dhe 5 vota për Dr. Doçi, edhe pse presioni i mbështetësve të saj ishte i fortë ndaj të gjithë anëtarëve të K. Kombëtar.

Po të kishte fituar ajo, a do të konsideroheshin zgjedhjet e rregullta?

Ky është kriteri i vleresimit të tyre .

Ne shprehim habinë përsëri se si gjykatësi quan të padrejtë faktin, se presidentet e K. Rajonal janë anëtar të K. Kombëtar duke i quajtur të emëruar ata, në një kohë që kemi dokumentuar me fakte se janë votuar nga Asamblea e Kombëtare. Pra janë votuar 3 herë, një herë nga asambletë lokale për në Këshillin rajonal, nga Këshillat Rajonale si president të tyre, dhe së fundi nga Asambleja e Përgjithshme për anëtar të këshillit kombëtar.

Pyesim cili nen i ligjit nr.123/2014 mbi U.M.SH.-në është shkelur për zgjedhjen e tyre.

Ky "argument" është një pretekst për të mbështetur një "padi të sajuar".

Ne deklarojmë se me dokumenta është vërtetuar se në çdo hap të fushatës zgjedhore kemi zbatuar dhe respektuar vetën ligjin, përvojën tonë dhe praktikën e organizmave ndërkombëtare homologe. Udhëzimet e aprovuar nga K. Kombëtar i mëparshëm kanë orjentuar fushatën zgjedhore, por gjithçka është vendosur pasi është votuar dhe fituar me shumicën dërmuese, gjykatësi ynë nuk ka bërë drejtësi, por ka zbatuar porosi të atyre që i thanë apo i dhanë, për të marrë këtë vendim duke dëshmuar edhe njëherë gjendjen e drejtësisë sonë.

Shpresojmë se reforma e shumë prituri në drejtësi do të krijojë kushtet për të korigjuar këtë padrejtësi, duke na gjykuar drejt në Gjykatën Administrative të Apelit, ku e kemi apeluar çështjen.

Homologët ndërkombëtar sapo janë vënë në dijeni për këtë ndodhi të pa precedent janë surprizuar dhe së shpejti ne do të publikojmë dhe qëndrimet e tyre.

Ftojme së pari bashkësinë e mjekëve, publikun shqiptar të cilëve ju shërbejmë si dhe gjithë drejtuesit e institucioneve të larta shtetërore të shprehin opinionin e tyre për të respektuar pavarësinë dhe gjithë tiparet e tjera që institucionit tonë ia garanton ligji.

Në respekt dhe zbatim të ligjit: **"LËRENI U.M.SH.-në TË PUNOJË, MOS JA HUMBISNI KOHËN KOT NË DYERT E GJYKATAVE"**

Tiranë, më 28.10.2015